

VENDIM
Nr.250 datë 5.6.1992

PËR KOORDINIMIN DHE KONTROLLIN E INVESTIMEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit dhe të Ministrisë së Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Turizmit ngarkohet për koordinimin dhe kontrollin e veprimtarisë turistike dhe të investimeve të kapitalit të huaj e vendas për ndërtimin e objekteve e të strukturave turistike të vendit.

2. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit ngarkohet të organizojë kryerjen e studimit të përgjithshëm urbanistik, të zonave urbanistike dhe të platformës së zhvillimit turistik të vendit, sipas detyrave dhe porosive të dhëna nga Ministria e Turizmit dhe në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, me organet lokale të pushtetit e organet e specializuara dhe me Institutin e Studimeve e të Projekteve të Urbanistikës në Tiranë, si dhe të përcaktojnë kriteret e platformës së zhvillimit të tyre dhe ta paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Faza e parë e studimit të përfundojë brenda datës 30.6.1992, kurse faza e dytë brenda datës 31.12.1992.

Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit të krijojnë Këshillin ndërtimor të turizmit me numër të barabartë anëtarësh nga të dy ministrinë, i cili të përzgjedhë të gjitha ofertat në fushën e turizmit. Ofertat për ndërtime turistike paraqiten në Ministrinë e Turizmit.

Vendimet e Këshillit hyjnë në fuqi pasi të jenë miratuar nga dy ministrat përkatës.

Përbërja dhe kompetencat e Këshillit ndërtimor të turizmit përcaktohen në një urdhër të përbashkët të të dy ministrave.

4. Deri në përfundimin e studimit të përgjithshëm urbanistik të zonave urbanistike dhe të platformës së zhvillimit turistik të vendit veprohet si vijon:

a) Brenda vijave kufizuese të qyteteve e të fshatrave, në përputhje me studimet urbanistike të zhvillimit të tyre, personat fizike e juridikë vendas e të huaj mund të ndërtojnë ose të ngrenë objekte a struktura turistike, vetëm pasi të jenë pajisur fillimisht me licencën përkatëse nga Ministria e Turizmit dhe pasi të miratohet sheshi i ndërtimit nga organet e parashikuara nga dispozitat në fuqi.

Për objektet hoteliere me kapacitet më shumë se 30 shtretër dhe për objektet e tjera turistike që zënë një sipërfaqe mbi 0,2 ha, sheshi i ndërtimit të miratohet nga Këshilli Ndërtimor i Turizmit.

b) Jashtë vijave kufizuese të qyteteve dhe fshatrave, si dhe gjatë bregdetit të vendit në gjerësinë e përcaktuar nga vija kufizuese bregdetare, ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe organeve lokale të pushtetit (të rrethit, të qytetit dhe të fshatit) u ndalohet dhënia e lejeve të ndërtimit për çdo lloj objekti, me përjashtim të objekteve që përcaktohen në nenin 14 të ligjit "Për token".

c) Ndërtimi i objekteve turistike jashtë vijave kufizuese bregdetare do të bëhet mbi bazën e studimeve urbanistike pjesore, të hartuara dhe të miratuara nga organet kompetente të specializuara, lokale ose qendrore, dhe me licencën e miratuar nga Ministria e Turizmit.

ç) Të gjitha lejet dhe sheshet e ndërtimit, të dhëna deri tani për objektet e strukturat turistike nga ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe organet lokale të pushtetit, të pezullohen deri në përfundimin dhe miratimin e studimit të përgjithshëm urbanistik për zhvillimin turistik bregdetar. Përjashtohen ato sheshe që janë dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për të cilët është lidhur kontratë nga Albturizmi.

d) Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, brenda datës 15.6.1992, t'i paraqesë Këshillit të Ministrave për miratim vijën kufizuese bregdetare.

5. Neni 46 i urdhërësës së Këshillit të Ministrave nr.8, datë 1.8.1990 "Për investimet dhe ndërtimet themlore", shfuqizohet .

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.213, datë 23.6.1990 "Për ndalimin e ndërtimeve në vijën bregdetare nga lumi Buna deri në këpin e Stillos dhe në qendrat turistike të vendit", si dhe aktet e

tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi